HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

RAPORTI I MONITORIMIT TË QENDRËS PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK - NARIC *2023*



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Autorë:
Gramos Buçinca & Olisa Çekaj

Monitoruese:
Liridona Ademaj

Prishtinë, Korrik 2024

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

05 **Hyrje**

07 **Si punon dhe ku e ka bazën ligjore qendra NARIC?**

13 **Të dhënat mbi njohjen dhe verifikimin në vitin 2023**

15 Të dhënat për njohjen e diplomave
13 sipas shteteve origjinë
19 Diplomat e njohura të nivelit të doktoratës
21 Diplomat e njohura të nivelit master
23 Diplomat e njohura në nivelin e studimeve themelore – bachelor
25 Tabela e plotë e njohjeve sipas niveleve të studimit dhe shteteve origjinë të diplomave
27 Të dhënat për njohjen e diplomave sipas fushës së studimit

29 Verifikimi

30 **Sfidat**

41 **E ardhmja e Qendrës NARIC**

Hyrje

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik e njohur si qendra NARIC nga anglisht *National Academic Recognition and Information Center* (tutje qendra NARIC) së bashku me Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përbëjnë dy filtrat kyç që mbrojnë cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë. Kjo qendër është përgjegjëse për njohjen e diplomave të fituara jashtë Kosovës, që do të thotë, është mbrojtja e parë nga diplomat false, e sidomos të atyre të doktoratës, bartësit e të cilëve tentojnë të futen në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë si profesorë.

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim bën monitorimin e vendimeve dhe mbledhjeve të qendrës NARIC, për të siguruar transparencë të procesit. Tutje, përmes projekteve si Intervenim në Arsim të Lartë 2025 (ang. shkurt HEI25) dhe Kualiteti Llogaridhënia Integriteti dhe Transparenca (ang. shkurt QAINT),

të mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim, është dhënë ndihmë teknike për identifikimin dhe zgjidhjen e vështirësive të qendrës.

Ky raport është ndërtuar mbi monitorimin e punës së qendrës NARIC në vitin 2023. Në kapituj përshkruhen të dhëna për njohjen dhe verifikimin e diplomave, origjinën e diplomave, sfidat dhe të ardhmen e qendrës NARIC.

Si punon dhe ku e ka bazën ligjore qendra NARIC?

Definicionet kryesore

QENDRA NARIC - është përgjegjëse për verifikimin dhe njohjen e diplomave të fituara brenda dhe jashtë Kosovës respektivisht. Ajo po ashtu ofron informacion në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja, si dhe për sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve të tjera. Ajo përbëhet nga Zyra e Qendrës dhe Këshilli Shtetëror për Njohje.

KËSHILLI SHTETËROR PËR NJOHJE (KShNj) – është organ brenda qendrës NARIC i përbërë nga disa anëtar, i cili merr vendime për njohje apo barasvlerë duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari i Qendrës dhe në raste të veçanta, bazuar në rekomandimin e komisionit të ekspertëve. Përbëhet nga profesorë universitar nga të gjitha fushat e studimit sipas kategorive të qendrës NARIC.

NJOHJE – do të thotë një pranim zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë (MAShTI), i një diplome të fituar jashtë vendit. Njohja, ose nostrifikimi siç është quajtur në të kaluarën, shërben si dëshmi që diploma e fituar jashtë Kosovës vlen brenda saj.

VERIFIKIM – do të thotë një pranim zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë (MAShTI), i një diplome të fituar brenda vendit. Ky shërbim i certifikimit të diplomës ka për qëllim lehtësimin e pranimit jashtë Kosovës të diplomave dhe kredive të fituara nga institucionet e akredituara brenda Kosovës.

INFORMIMI AKADEMIK – është shërbimi i tretë që qendra NARIC e kryen për institucionet dhe qytetarët në Kosovë dhe ka të bëjë ndër të tjera me qartësimin e fushave të studimit të diplomave, interpretimin e notave mesatare dhe kredive.

BARASVLERË – do të thotë një pranim zyrtar nga ana e MAShTI-it i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe bën krahasueshmërinë me nivelin e diplomave dhe fushës studimore përkatëse në vend. Qendra NARIC në vitin 2023 nuk ka bërë barazvlerësime.

Baza ligjore dhe procedurat

Qendra NARIC aktualisht vepron duke u bazuar në legjislacionin në fuqi si më poshtë:

- Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës [1]
- Udhëzimin Administrativ për verifikimin e dokumentacionit shkollor (Publik dhe privat) për nevojat e kandidatëve që shkollohen jashtë shtetit.[2]
- Udhëzimin Administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës.[3]
- Rregullorja e punës së Këshillit Shtetëror për Njohje dhe Komisioneve nga Fushat Përkatëse

[1] Ligji për Arsimin e Lartë, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761
[2] Udhëzimi Administrativ për Verifikimin e Dokumentacionit Shkollor (Publik dhe privat) për Nevojat e Kandidatëve që Shkollohen Jashtë Shtetit, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10210
[3] Udhëzimi administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, linku, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15228
[4] Faqja e Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave: https://naric-ks.online/

Diplomat e fituara në universitete publike të rajonit dhe në universitete që gjenden në listat e rangimeve botërore si në Academic Ranking of World Universities (ARWU), Times Higher Education World University Ranking (THE) dhe QS World University Ranking, pasi arrijnë të konfirmohen nga shteti përkatës se janë autentike dhe të vlefshme, miratohen nga qendra NARIC pa kaluar nëpër Këshillin Shtetëror për Njohje.

Këshilli Shtetëror për Njohje, konkretisht anëtari i fushës së studimit prej të cilës është fituar diploma shqyrton fillimisht aplikimin për njohje të diplomës mirëpo në rast të ndonjë paqartësie ai aplikim diskutohet edhe me anëtarët e tjerë të këshillit, në të kundërtën pas shqyrtimit nënshkruhet nga anëtari i fushës përkatëse dhe aplikuesi pranon vendimin nga qendra NARIC se diploma i është njohur.

Qendra NARIC, kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC), mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas Kornizës Kombëtare/Evropiane të Kualifikimeve, si dhe informacione tjera shtesë në funksion të njohjes/barasvlerës të diplomës.

Aplikimi për njohje të kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës është i mundur përmes ueb faqes së kësaj qendre. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të kalojnë përmes procesit të njohjes nga ana e Ministrisë së Arsimit për të konfirmuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, ndërsa diplomat e fituara brenda vendit duhet të kalojnë nëpër procesin e verifikimit për të vërtetuar vlefshmërinë e diplomës dhe ekuivalencën e kredive në mënyrë që të lehtësohet pranimit i këtyre diplomave jashtë Kosovës.

Të dhënat mbi njohjen dhe verifikimin në vitin 2023

Të gjetura kyçe

- 881 vendime për njohje të diplomave janë lëshuar nga Qendra NARIC. Një diplomë nga Shqipëria nuk është njohur. Pesë diploma të tjera që kanë pasur origjinën në Serbi nuk janë njohur. Tri raste janë bartur në vitin 2024.

- Maqedonia e Veriut është shteti me më së shumti diploma të lëshuara të cilat janë njohur në Kosovë. 354 diploma ose 40% e të gjitha diplomave të njohura në 2023 i takojnë këtij vendi. Shqipëria është shteti i dytë me më së shumti diploma të njohura në Kosovë në 2023, me 152 ose 17%.

- Në Maqedoni të Veriut, Shqipëri dhe Turqia janë fituar 72% e të gjitha diplomave të njohura në 2023.

- Niveli i diplomave të njohura: 163 doktoratë (19%), 478 master (54%), baqelor 234 (27%), dhe shkollim i lartë 6 (<1%).

- Më së shumti doktoratura të njohura në 2023 kanë qenë me origjinë nga Maqedonia e Veriut – 60 sosh ose 37% të doktoraturave.

- 29% të diplomave të njohura në 2023 janë nga fusha e shkencave të mjekësisë dhe sportit, 18% janë nga shkencat sociale, të edukimit dhe humane, dhe 9% nga ekonomia.

- 3212 diploma të fituara në institucione arsimore brenda Kosovës janë verifikuar nga qendra NARIC në 2023.


Njohja

Njohja e diplomës është akt i pranimit të vlefshmërisë të diplomës së fituar jashtë Kosovës. Më poshtë janë të tabelarizuara të dhënat për shtete, fusha të studimit dhe nivele të shkollimit.

Të dhënat për njohjen e diplomave sipas shteteve origjinë

881 diploma të fituara jashtë Kosovës janë njohur nga qendra NARIC. Këto diploma janë fituar në 36 shtete të huaja. Në Maqedoni të Veriut, Shqipëri dhe Turqi janë fituar 72% e të gjitha diplomave të njohura në 2023.

Diplomat e njohura në 2023 sipas shteteve origjinë



Diplomat e njohura në 2023 sipas shteteve origjinë

Jordani	4
Suedi	3
Mal i Zi	3
Indi	3
Belgjikë	3
Pakistan	2
Izrael	2
Egjipt	1
Estoni	1
Finlandë	1
Holandë	1
Irlandë	1
Kanada	1
Kinë	1
Poloni	1
Portugali	1
Qipro	1
Ukrainë	1

Maqedonia e Veriut mbetet shteti favorit i kosovarëve që dëshirojnë të studiojnë jashtë Kosovës. Shtojmë këtu edhe numrin e shumë shqiptaro-maqedonasve që veprojnë në Kosovë, atëherë mund të jetë e pritshme që shteti me më së shumti diploma të lëshuara që janë njohur në vitin 2023 në Kosovë është Maqedonia e Veriut.


Shqipëria zë vendin e dytë për numrin e diplomave të lëshuara që janë njohur në Kosovë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri kanë shumë studentë kosovarë, si dhe prodhojnë profesionistë shqiptarë që vijnë të punojnë në Kosovë.

Turqia është vendi i tretë dhe shumë afër Shqipërisë për sa i përket origjinës së diplomave të njohura në Kosovë në 2023. Një numër i konsiderueshëm i kosovarëve studiojnë në Turqi, dhe shumë shtetas turq kanë filluar të veprojnë në Kosovë – proporcionalisht më shumë se në rastin e shtetasve shqiptarë.

Diplomat e njohura të nivelit të doktoratës


Grada më e rëndësishme shkencore është doktor i shkencës ose i filozofisë, që do të thotë kualifikim i nivelit 8 sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Individët që e posedojnë këtë titull mund të punësohen si profesorë në arsimin e lartë në Kosovë, nëse e kanë edhe një punim shkencor të publikuar në revista ndërkombëtare. ORCA i monitoron me kujdes të shtuar proceset dhe vendimet në zgjedhjet e profesorëve, dhe ka vërejtur në të kaluarën se individë të caktuar kanë tentuar që me diploma të marra në IAL fiktive të rajonit të zgjidhen si profesorë.

5 shtetet prirëse të origjinës së doktoratave të njohura në Kosovë në 2023



Në vitin 2023 janë njohur 163 diploma të nivelit të doktoratës, që përbën 19% të të gjitha diplomave të njohura. Shteti origjinë me më së shumti doktorata të prodhuara që janë njohur në Kosovë është Maqedonia e Veriut. Shqipëria dhe Turqia janë të dytat në këtë. Këto tri shtete së bashku i kanë prodhuar 65% të doktoratave të njohura në Kosovë në vitin 2023. Janë 17 shtete të tjera që e përbëjnë 35%-shin e mbetur.


5 shtetet prirëse të origjinës së doktoratave të njohura në Kosovë në 2023



Diplomat e njohura të nivelit master


Për nga numri i diplomave të njohura dominojnë ato të nivelit master. Në 2023 janë njohur 478 diploma master që përbën 54% të të gjitha diplomave të njohura.

5 shtetet prirëse të origjinës së diplomave master të njohura në Kosovë në 2023



Tri shtetet nga të cilat Kosova ka importuar më së shumti diploma master janë Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Turqia. Duhet theksuar se kjo gradë shkencore ka pasur më shumti njohje krahasuar me gradat e tjera. Mbi gjysma e diplomave të njohura në Kosovë në vitin 2023 kanë qenë të kësaj grade.


76% e të gjitha diplomave të master që janë njohur në Kosovë në vitin 2023, vijnë nga tri shtetet e para në tabelë.



Diplomat e njohura në nivelin e studimeve themelore – bachelor


Në 2023 janë njohur 236 diploma të nivelit të studimeve themelore – bachelor, që përbën 27% të të gjitha diplomave të njohura në Kosovë.

5 shtetet prirëse të origjinës së diplomave bachelor të njohura në Kosovë në 2023



Sa i përket gradës bachelor edhe këtu Maqedonia e Veriut prinë si vendi origjinë i mbi 30% të të gjitha diplomave të njohura në Kosovë në 2023.

Turqia është e dyta para Shqipërisë në renditjen e shteteve origjinë të diplomave bachelor të njohura në Kosovë në 2023, ndërkaq Arabia Saudite ka arritur të futet në top 5-she. Në vitin 2023, 24 diploma me fushë të studimit fetar janë njohur në Kosovë, 10 prej tyre janë nga Arabia Saudite.



5 shtetet prirëse të origjinës së diplomave **bachelor** të njohura në Kosovë në 2023

Tabela e plotë e njohjeve sipas niveleve të studimit dhe shteteve origjinë të diplomave


Shteti	Doktoraturë	Master	Bachelor	Të tjera
Maqedonia e Veriut	60	219	75	
Shqipëria	22	98	32	
Turqi	22	46	62	5
ShBA	3	14	14	
Mbretëri e Bashkuar	1	21	8	
Itali	5	17	3	
Bullgari	15	2	1	
Arabia Saudite			13	
Hungari	2	10	1	
Kroaci	2	8	3	
Gjermani	3	7	2	
Austri	4	3	4	
Francë	2	5	4	
Zvicër	3	3	2	
Bosnje dhe Hercegovinë	2	1	4	
Sllloveni	6	1		
Greqi		5	1	
Jordani	1	1	2	
Çeki	2	2		

Tabela e plotë e njohjeve sipas niveleve të studimit dhe shteteve origjinë të diplomave

Shteti	Doktoraturë	Master	Bachelor	Të tjera
Belgjikë		3		
Indi	1	2		
Mal i Zi	1	1	1	
Suedi		2		1
Izrael	2			
Pakistan			2	
Egjipt			1	
Estoni		1		
Finlandë			1	
Holandë		1		
Irlandë		1		
Kanada	1			
Kinë		1		
Poloni		1		
Portugali	1			
Qipro		1		
Ukrainë		1		
Total	**161**	**478**	**236**	**6**

Të dhënat për njohjen e diplomave sipas fushës së studimit

Janë 11 fusha të studimit të kategorizuara sipas qendrës NARIC. Në grafikën e mëposhtme shihet numri i diplomave sipas fushave të studimit i shprehur në përqindje.



Qendra NARIC shfrytëzon kategorizimet e veta të fushave të studimit për njohje të diplomave. Sipas këtij kategorizimi, 29% e diplomave të njohura në 2023 i takojnë fushës së mjekësisë dhe sportit. Kjo do të thotë që kualifikimet shëndetësore dhe në një masë të vogël ata të sportit, janë importuar më së shumti në Kosovë. Mjekësia dhe sporti, së bashku me atë sociale, të edukimit dhe humane janë fushat e studimit të gati gjysmës së diplomave të importuara dhe të njohura në Kosovë.

Feja përbën 3% të fushave të studimit të diplomave të njohura në Kosovë, që është përqindja e parafundit pas asaj të fushës së bujqësisë dhe veterinarisë. Të gjitha diplomat e fushës fetare janë marrë gjatë studimeve të bëra në lindjen e mesme, me përjashtim të njërës në ShBA, dhe të gjitha i takojnë fushë së fesë islame.

Verifikimi

Verifikimi është akt i pranimit ë diplomave apo kualifikimeve të marra në institucione të Kosovës. Rëndom ka më shumë kërkesa për verifikim sesa për njohje.

3,229 diploma janë shqyrtuar për verifikim në vitin 2023. 3212 janë verifikuar, 17 jo. Nga ato të verifikuara 1,472 i takojnë diplomave të marra në institucione private të arsimit të lartë, dhe 1,740 i takojnë atyre publike.

Sfidat

Shumica e sfidave me të cilat është përballur qendra NARIC në vitin 2023 janë të njëjta me ato të viteve të mëparshme. Gjatë vitit 2023 me mbështetjen e projektit HEI25 është bërë vlerësimi i nevojave të qendrës, dhe është prodhuar një raport me rekomandime për tejkalimin e tyre. Në vazhdim janë të listuara sfidat kyçe që janë hasur gjatë monitorimit të qendrës, si dhe janë përmbledhur sfidat e tjera të identifikuara gjatë vlerësimit të nevojave.

- Stafi i pamjaftueshëm
- Mungesa e bazës së të dhënave
- Programet e pa akredituara
- Profilet e keqpërdorura në SMIAL
- Pamundësia e anëtarësimit në ENIC
- Sfidat e tjera të identifikuara në raportin e vlerësimit të nevojave
- Paditë

Staf i pamjaftueshëm

Prej sfidave kryesore të qendrës NARIC Kosova është stafi i limituar. Puna kryesore e qendrës konsiston në trajtimin e aplikimeve për njohje dhe verifikim të diplomave. Kjo ka bërë që në periudha të caktuara të vitit stafi të jetë tërësisht i angazhuar në punën me palë. Qendra ka trajtuar mesatarisht 3 lëndë për njohje të diplomës dhe 12 lëndë të verifikimit të diplomës në ditë, në 2023. Në periudha të caktuara këto të fundit kanë shkuar edhe në 20-25 lëndë në ditë.

Në vitin 2023 në qendrën NARIC kanë punuar gjashtë persona.

Mungesa e bazës së të dhënave

Për momentin Qendra NARIC shërbehet me një platformë digjitale të aplikimit për njohje dhe verifikim të diplomave. Fatkeqësisht kjo platformë nuk mund të prodhojë të dhëna të përmbledhura mbi llojin e diplomave, fushën e studimit, nivelit, shteteve origjinë dhe të gjitha kombinimeve të tjera, mbi të cilat mund të orientohen politikat e qendrës.

Ky raport ka grumbulluar të dhëna që janë nxjerrë në mënyra manuale nga stafi i qendrës – një proces i cili shumë lehtë mund të ishte automatizuar në një bazë së të dhënave digjitale. Një databazë e tillë do të mundësonte të kuptojmë psh.:

- Cilat janë shtetet me numrin më të madh të diplomave të nivelit të doktoratës të cilat vijnë për tu njohur në qendër? A ka ndonjë prej tyre që ka numër abnormalisht të madh të diplomave të tilla?

- Nëse psh. nga shteti X janë fituar 50% e diplomave të doktoratës që vijnë për njohje, atëherë duhet të shikohet se çfarë cilësie kanë ato, dhe nëse është nevoja të krijohen politika të veçanta për këto raste të cilat potencialisht mund të dëmtojnë tregun e punës në Kosovë.

Të dhëna të ngjashme mund të nxirren edhe për verifikimin e diplomave vendore. Psh. mund të kuptojmë se çfarë profile janë duke kërkuar verifikim për të punuar jashtë Kosovës. Kjo do të ndihmonte për të ikjen e punëtorëve me aftësi të caktuara si mjek, infermier, inxhinier etj.

Programet e pa akredituara

Një nga arsyet kryesore e mos njohjeve dhe mos verifikimeve të diplomave është se ato janë marrë në programet ose institucionet që nuk kanë pasur akreditim. Shumica e këtyre rasteve janë diploma të fituara para shumë kohësh, kur nuk kanë ekzistuar mekanizma të fortë të sigurimit të cilësisë në Kosovë dhe rajon.

Duhet theksuar se deri para pak kohësh programet studimore në Shqipëri janë akredituar me vendim të Ministrit të Arsimit, pa verifikim të thukët të cilësisë të bërë nga një agjenci e pavarur siç janë agjencitë e akreditimit ose të sigurimit të cilësisë. Shumë nga diplomat e fituara gjatë asaj kohe janë marrë në universitete fiktive të cilat më vonë do të ishin objekt i organeve të rendit në Shqipëri, siç ishte rasti me Universitetin Kristal, i cili lëshonte diploma pa prezencë të studentëve, kishte ndërtesa pa leje dhe programe studimore false.[5]

[5] Skandal me Universitetin "Kristal", diplomë me 10 ditë prezencë, godina pa leje, regjistrime pa programe dhe diploma false. (2014) Sot.com.al.

Viktimat kryesore të këtyre rasteve kanë qenë studentët të cilët nuk kanë qenë në dijeni që programet ose institucionet ku ata janë regjistruar nuk kanë pasur akreditim.

Profilet e keqpërdorura në SMIAL

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsimin e Lartë (SMIAL) është regjistri i të gjithë studentëve të institucioneve vendore të arsimit të lartë. Çdo student që regjistrohet në një program studimor të akreditуar në Kosovë, figuron edhe në SMIAL. Ndër të tjera, kjo bëhet edhe për të zbatuar kuotat e numrit të studentëve, të cilat janë lejuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, që do të thotë se nëse një program është akreditуar për të pasur 40 studentë, atëherë ky numër mund të monitorohet përmes SMIAL.

Për arsye të ndryshme, ky regjistër është manipuluar për të fshirë, shtuar apo ndryshuar profilet studentore jashtë procedurave ligjore. Si rrjedhojë ka pasur një numër të konsideruar të studentëve të cilët kanë diplomuar dhe nuk kanë figuruar në SMIAL. Për këtë arsye kur kanë aplikuar për verifikim të diplomës në qendrën NARIC kanë marrë përgjigje negative.

Ky problem nuk është trajtuar në plotni nga MAShTI dhe nga organet e ligjit në Kosovë, duke lënë shumë studentë me diploma të cilat nuk njihen nga shteti i Kosovës. Si pasojë këta studentë janë përjashtuar nga mundësitë e punësimit apo shkollimit në ato institucione ku kërkohet njohje zyrtare nga qendra NARIC, përfshirë sidomos edhe institucionet jashtë vendit.

Pamundësia e anëtarësimit në ENIC

Kosova nuk është anëtare e Rrjetit Evropian të Qendrave të Informacioni (tutje ENIC nga anglisht European Network for Information Centers). Kjo për shkak se Kosova nuk është anëtare e UNESCO dhe e Këshillit të Evropës, që janë themeluesit e ENIC.

Anëtarësimi i Kosovës në ENIC do thotë njohje më të lehtë të kualifikimeve akademike dhe profesionale, duke lehtësuar lëvizshmërinë për arsim dhe punësim. Ndonëse qendra NARIC nuk është pjesë e ENIC, në formë të konsiderueshme ajo zbaton parimet dhe standardet e saj.

Fatkeqësisht problemi politik i anëtarësimit të Kosovës në KE dhe UNESCO do të penalizoj studentët, stafin akademik dhe profesionistët që përmes ENIC do të mund të kishin qasje më të madhe në treg të punës dhe shkollim.

Sfidat e tjera të identifikuara në raportin e vlerësimit të nevojave

Në nëntor të vitit 2023 është publikuar raporti 'NARIC Kosova - Shfrytëzimi i Mjeteve Digjitale'[6] nga Qendra për Arsim e Kosovës me financim të projektit HEI25. Në këtë raport janë identifikuar nevojat e qendrës NARIC si dhe janë dhënë rekomandime për tejkalimin e tyre dhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të qendrës. Përtej atyre të përmendura më lartë, në këtë raport janë identifikuar edhe sfidat si në vijim:

- Platformë e kufizuar e aplikimit për njohje në arsim të lartë
- Mungesa e platformës digjitale për verifikim
- Mungesa e platformës digjitale për njohje në arsim para universitar
- Ekuivalenca e notave mesatare dhe kredive ECTS
- Mungesa e qartësisë në informim akademik

[6] NARIC Kosova – Shfrytëzimi i Mjeteve Digjitale. 2023. Colin Tuck dhe Arben Sahiti. Qendra për Arsim e Kosovës. Projekti HEI25.

Disa nga rekomandimet kryesore kanë të bëjnë qartësimin e roleve dhe rregullave të njohjes së diplomave të arsimit të lartë si dhe me zhvillimin më të madh të zgjidhjeve digjitale për proceset në qendër.

Paditë

Gjatë viti 2023 kanë qenë katër padi të pa kryera kundër qendrës NARIC. Të gjitha kanë pasur të bëjnë me mos njohjen e diplomës nga ana e qendrës, qoftë për shkak të mospërputhjes së nivelit, apo për arsye të tjera.

E ardhmja e Qendrës NARIC

Digjitalizimi

Qendra NARIC është e orientuar në digjitalizimin e të gjitha proceseve brenda saj, përfshirë edhe grumbullimin dhe raportimin e të dhënave. Për këtë gjë qendra është duke përdorur mbështetjen e nivelit të lartë të qeverisë, MAShTI-t si dhe projekteve të huaja siç është HEI25. Me këtë të fundit, pas mbështetjes në vlerësimin e nevojave të qendrës, do të bëhet edhe dixhitizimi i lëndëve të arkivuara nga viti 2014.

Tutje, me kërkesën edhe të Zyrës së Kryeministrit, do të krijohet një bazë e të dhënave, e cila do shërbej për të prodhuar informacion real mbi të cilat mund të orientohen politikat për njohje dhe verifikim, me qëllim në njërën anë mbrojtjen dhe sigurimin e cilësisë së arsimit në Kosovë, dhe në anën tjetër lehtësimin e lëvizshmërisë për punësim dhe arsimim të qytetarëve.

Procedura të reja

Në të kaluarën e afërt qendra NARIC është kritikuar për mungesën e bazës ligjore mbi të cilat i ka bazuar udhëzimet administrative dhe rregullativat e tjera dytësore. Për këtë gjë qendra është duke i rishikuar dokumentet e saja rregulluese për të i harmonizuar ato me ligjet në fuqi.

Rregullorja e re e Këshillit Shtetëror për Njohje ka lehtësuar punën e tij dhe ka rritur funksionalitetin. Këtu përfshihen edhe procedurat e qarta të zgjedhjes së kryesuesit, si dhe mbajtja më e shpeshtë e mbledhjeve në të cilat merren vendimet përfundimtare për njohje dhe verifikim.

Me qëllim të harmonizimit të rregullativave me ENIC, dhe për të përshpejtuar proceset integruese në Bashkimin Evropian, qendra NARIC është duke i rishikuar procedurat e saja të njohjes së diplomave të fituara jashtë Kosovës.

Këtu përfshihen edhe mundësitë për adaptimin e tri proceseve të veçanta për njohje të diplomave nga shtetet anëtarë të ENIC, shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe të gjitha të tjerave.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim